



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr 6 Datë 17.06.2026

“Për miratimin e pranimit të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të "Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 24 “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, neni 54, shkronja “dh”, si dhe neni 64, shkronja “gj”; Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKB-së nr 20 datë 26.03.2026 “Për miratimin e planit social vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës” me shprehje ligjeshmerie nr 246/1 prot datë 08.04.2025 të Prefekti i Qarkut Shkodër; Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligji Nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026; Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimin Nr.02, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit 2026”; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.74, datë 23.12.2026 “Per miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”; Shprehjen e Ligjshmërisë nga Prefektura Shkodër me Nr.884/1 Prot, datë 07.01.2026; Leter-Marrveshjes standarte mes përfaqësuesve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (“UNDP”) në Shqipëri dhe Bashkisë Vau Dejës (Pala Përgjegjëse) lidhur me zbatimin e programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara e projektit nr. 01005254, “Leave No One Behind” protokolluar me Nr 4910, Datë 02/07/2026, ku në mbledhjen e dates ____/____ 2026 të Këshillit të Bashkisë:

VENDOSI

1. Për miratimin e pranimi të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"

Projekti financohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nr. 01005254, "Leave No One Behind" (ASKUSH TË MOS MBETET PAS) sipas Letër Marrveshjes protokolluar me Nr 4910 Datë 02/07/2026. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 "Perkujdesi Social" shuma 5,809,547 (Pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë sipas detajimit me poshtë:

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali				
Shuma	(Lekë)	Paga	Sigurime	Shpenzime Operative	Kapitale
TOTALI	5,809,547	929,376	155,208	350,000	4,374,963

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Aleksandra Gjoni



KRYETAR
Kristian Shkreli

Miratoi:

Ridvon Luzaku : Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

Elise Ruzhiti : Drejtor/ Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar.

Armando Daba Gjoni : Drejtor/ Drejtoria Juridike e Integritetit Prokurimeve dhe Aseteve.

Konceptoi:

Greta Bobani : Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE

RELACION SHPJEGUES

“Për miratimin e pranimin të grantit të akorduar nga UNDP për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, si dhe për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me VKB nr. 74, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të përmbushjes së funksioneve të saj në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe të mbështetjes së kategorive në nevojë, ka zhvilluar konsultime dhe komunikime me Perfaqësues të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP në Shqipëri, me qëllim ngritjen dhe vënien në funksionim të një Qendre Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.

Kjo nismë synon zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Vau Dejës, duke krijuar një shërbim të specializuar, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Në vijim të konsultimeve ndërmjet përfaqësuesve të UNDP-së në Shqipëri dhe përfaqësuesve të Bashkisë Vau Dejës, është rënë dakord për zbatimin e projektit **me titull** “Ngritja dhe funksionimi i Qendrës Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuara”, në kuadër të programit “Leave No One Behind” (ASKUSH TË MOS MBETET PAS).

Për realizimin e këtij projekti, UNDP akordon për Bashkinë Vau Dejës një grant në vlerën totale prej 5,809,547 lekë/, i cili do të përdoret për:

- rikonstrukcionin dhe përshtatjen e ambienteve të Qendrës;
- mobilimin dhe pajisjen e ambienteve;
- sigurimin e pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve;
- mbështetjen e funksionimit të Qendrës;
- mbulimin e shpenzimeve të tjera të parashikuara në buxhetin e projektit.

Qendra do të ofrojë shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara, të tilla si:

- shërbime psikologjike;
- terapi fizike;
- terapi të të folurit;
- edukim dhe zhvillim;
- mbështetje psikosociale;
- punë me familjet dhe prindërit;
- orientim dhe referim drejt shërbimeve të tjera të nevojshme.

Leter-Marrëveshja ndërmjet Bashkisë Vau Dejës dhe UNDP-së është e hartuar në gjuhën angleze, sipas formatit standard dhe gjuhës së punës së donatorit. Për qëllime të shqyrtimit, transparencës dhe vendimmarrjes nga Këshilli Bashkiak, në këtë relacion shpjegues paraqiten në gjuhën shqipe qëllimi i projektit, vlera e grantit, mënyra e përdorimit të fondit dhe rezultatet e pritshme.

Qëllimi i projekti;

Ngritja dhe funksionimi i një qendre komunitare ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës 0-16 vjeç, me synim ofrimin e shërbimeve të integruara zhvillimore, rehabilituese dhe psiko-sociale, si dhe mbështetje për familjet e tyre.

Qendra synon ;

- Ndërhyrje të hershme për moshat 0-16 vjeç
- Mbështetje për zhvillimin dhe integrimin arsimor për moshat 6-16 vjeç
- Rritjen e autonomisë dhe aftësive funksionale;
- Përfshirjen sociale të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Në zbatim të marrëveshjes, Bashkia Vau Dejës do të ketë përgjegjësinë për:

- ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve të projektit;
- administrimin dhe përdorimin e fondit sipas qëllimit të përcaktuar;
- kryerjen e procedurave përkatëse administrative dhe financiare;

- sigurimin e ambienteve për ngritjen e Qendrës;
- garantimin e vijimësisë së shërbimit pas përfundimit të financimit të donatorit;
- raportimin financiar dhe narrativ sipas kërkesave të UNDP-së;

Për realizimin e projektit dhe administrimin e fondit të akorduar, është i nevojshëm pasqyrimi i grantit si shtesë në planin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Bashkisë Vau Dejës.

Buxheti i Bashkisë Vau Dejës është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74, datë **23.12.2025**, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028, numrin të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës’.

Për rrjedhojë, propozohet miratimi i shtesës në planin e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës në vlerën 5,809,547 (Pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë, sipas shpenzimeve të llogaritura mëposhtë:

-Paga dhe sigurime në vlerën 1,084,584 (Një milion e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, për 4 profesionist – Psikolog, Punonjes Social, Edukator Zhvillimi, Fizioterapist, për tre muaj.

-Shpenzime operative 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për material didaktike pune, higjienë, printime, pritje).

-Shpenzime kapitale në vlerën 4,374,963 (Katër milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, për rikonstrukcion dhe mobilim të qendres.

Rezultatet e pritshme

Rezultat 1: Ngritja dhe venia në funksionim e qendrës ditore komunitare

- Hartimi dhe venia në zbatim e modelit të shërbimit
- Rekrutimi dhe trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve cileore për fëmijet me aftësi të kufizuara
- Hartimi dhe miratimi i rregullores së shërbimit dhe procedurave të menaxhimit

Treguesit:

- Modeli i shërbimit komunitar për fëmijet me aftësi të kufizuara i hartuar dhe miratuar nga Bashkia
- Qendra komunitare për fëmijet me aftësi të kufizuara është funksionale dhe ofron shërbimin e modeluar
- 4 profesionistë të rekrutuar dhe të punësuar

- Minimumi 10 ditë mbështetje për ngritje kapacitetesh të stafit
- Procedurat e punës të vendosura

Rezultat 2: Rehabilitimi dhe pajisja e ambienteve

- Rehabilitimi I ambienteve
- Pajisja e qendres me mobilje dhe materiale

Treguesit:

- Punimet e rehabilitimit të përfunduara sipas planit.
- Qendra e pajisur me mobilje dhe pajisje/materiale sipas specifikimeve të projektit.

Rezultat 3: Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjarët, dhe fuqizim i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me komunitetin

- Rritje e aksesit në shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara
- Mbështetje për prindër dhe familjarë
- Ndërgjegjësim i anetareve të komunitetit mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- Përmirësim i koordinimit institucional me arsimin dhe mesuesit ndihmes

Treguesit:

- 25 fëmijë përfitues të shërbimeve sipas nevojës/planit individual
- 3 aktivitete socializuese
- 5 takime me (50) prindërit
- 3 takime me institucione arsimore
- Minimumi 2 aktivitete ndërgjegjësuëse me 20 pjesëmarrës secili

Në përfundim, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projekti për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, kërkohet shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: Çuka Babani; Përgjegjëse/Spektori i Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve

Miratori : Ridvan Luzaku; Drejtor/ Drejtorja e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

2045924

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 8598
Numri i Pasurisë 1/23 Volumi 3 Faqe 16
Adresa e Pasurisë VAU-DEJES
Lloji i Pasurisë TRUALL
Sipërfaqja Totale 5334.00 m2
Nga kjo : Sa Truall 5,334.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 375.00
Nqs pallat: Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BASHKIA	VAU DEJËS		1/1	VAU-DEJES

- pasurisë me numër 1/23
- është pronar i _____
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 9/4/2020 Nr. 5381

Data e lëshimit të çertifikatës
30/4/2020

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

ILIR DIBRA

HARTE TREGUESE E RREGJISTRIMIT

(Fragment)

AGJENSIA SHTETERORE E KADASTRES

DREJTORIA VENDORE
SHKODER

DREJTORI:

Ing.Erjeta Ramaj

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 8598

NUMRI I PASURISE :1/23

VOL.

FAQE

INDEKSI I HARTES : L-D-5

SHKALLA : 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi: **SHKODER** Q/F: VAU I DEJES

B. KUFIZIMET

V.1/215

L.1/215

J.1/472

P.1/471

Dt.24.04.2020

C. PRONARI

BASHKIA VAU DEJES

Sip.tr.- 5334m2 nga kjo: Snd.-375



1. Prishje

1	2.310/2	✓	Prishja e suvase se brendshme	m2	224.4	116.44	26,128.24
2	2.43	✓	Prishje shtrese lluster çimento dyshemeje	m2	8.3	236.41	1,962.21
3	2.426	✓	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	0.53	1,561.19	827.43
				Shuma 1:			28,917.88

2. Punime Murature Tulle

4	2.108/1a	✓	Ndëtim muri me gips t=10cm me dy shtresa	m2	18.5	4,386.25	81,145.68
				Shuma 2:			81,145.68

3. Punime Tavani dhe Suvatimi

5	2.328/1	✓	Patinim muri me stuko	m2	224.4	1,140.12	255,843.83
6	2.310/1	✓	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	224.4	922.41	206,988.80
7	2.326	✓	Veshje me pllake majolike	m2	32.6	3,898.82	127,101.43
8	2.330/1	✓	Patinim tavani me stuko	m2	167	1,421.58	237,403.53
9	2.328	✓	Patinim muri allçi (stuko)	m2	37.1	607.48	22,537.40
				Shuma 3:			849,874.99

4. Punime Shtresash 2

10	2.281	✓	Heqje pllaka dyshemeje	m2	13.3	594.61	7,908.30
11	2.264	✓	Shtrese lluster çimento 1.2	m2	8.3	685.79	5,692.09
				Shuma 4:			13,600.39

5. Punime Dyer Dritare

12	2.383/1	✓	F.V Dyer te brendeshme druçi cilesi e l-re.	m2	20.3	21,753.51	441,596.33
13	2.395/1	✓	F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	34.9	16,883.54	589,235.62
14	2.370/1	✓	Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese	m2	51.4	741.78	38,127.54
				Shuma 5:			1,068,959.49

6. Nenshtresa dhe Shtresa ne Territorin e Ndertesave

15	2.267/a	✓	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	13.3	3,019.60	40,160.72
				Shuma 6:			40,160.72

7. Punime Hidrozolimi dhe Çatite

16	2.196/b	✓	Hidrozolim me nje shtres astar me baze çimento. Pergatitur nga dy komponente A + B	m2	25.9	978.98	25,355.45
				Shuma 7:			25,355.45

8. Punime Bojatisje

17	2.404/1	✓	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	421	601.41	253,192.35
18	2.410/a	✓	Parapet shkalle e ballkone me tuba inoxi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm	ml	6	7,587.57	45,525.40

Shuma 8: 298,717.74

9. Punime dheu

19	24	☒	Transport mbeturinash, nga prishje te brendshme te godines, me krahe	m3	6	3,581.98	21,491.90
Shuma 9:							21,491.90

10. Instalime per Ndrim

20	2.480/2 ✓	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	60	271.77	16,306.28
21	2.480/3 ✓	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	40	365.19	14,607.76
22	2.481/1 ✓	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	180	50.78	9,139.68
23	2.481/2 ✓	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	90	67.63	6,086.52
24	2.490/e ✓	F.V. Automat kryesor me 24 vende	copë	1	3,786.28	3,786.28
25	2.485/d ✓	F.V. Priza shuko universal	copë	8	1,009.37	8,074.92
26	2.485/1 ✓	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A	copë	16	896.23	14,339.63
27	2.47 ✓	F.V. Ndricues pllafonier muror 1x60w	copë	15	3,167.19	47,507.81
28	2.489 ✓	F.V Siguresa ~ 25 A	copë	2	551.35	1,102.70
29	2.490/1c ✓	F.V Automat termo/el.manj diferencial 2P 220V, 32A	copë	1	4,628.47	4,628.47
30	2.490/1b ✓	F.V Automat termo/el.manj, diferencial 2P 220V, 16A	copë	10	1,893.58	18,935.79
Shuma 10:						144,515.82

11. Instalime Hidro-sanitare dhe Nqrohje

[illegible]

12. Punime Ndrohtje dhe Termizolimi

41	2.535/2a	Termozolim me lesh xhami	m2	9.1	13,344.19	121,432.09
Shuma 12:						121,432.09

13. Punime te Ndryshme

42	3.708	✓	F.V. Konstruksiione metalike te thjeshta	cope	1	156,021.61	156,021.61
							Shuma 13:
							156,021.61



14. Analiza teknike per punimet dhe instalimet teknologjike

43	4.141/b4.8	F.V. Ne mure e konstruksione kablllo Al fuqie 6/10kV, me izolim gome e mbulesa plastmasi, i armuar, 3x120mm ²	m	1	3,542.28	3,542.28
						Shuma 14:
						3,542.28
						Shuma Analiza
						Fondi rezerve 5%
						3,093,621.73
						154,681.09
						Shuma (Analiza + Fondi Rezerve)
						3,248,302.82
						TVSH 20%
						649,660.56
						Shuma me TVSH
						3,897,963.38
						Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)
						0
						Shuma TVSH (për pajisje)
						0
						Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)
						0
						Totali
						3,897,963.38

Koncepti: Ing. Greta Rostija

PREVENTIV MOBILJE VAU DEJES

Nr/rend	Nr.art.	Pershkrimi i zerit te punes	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Nr.1	Tavoline Zyre MDF me skelet metalik dim.(1400 x 800 x 800 mm)	cope	3	20,000	60,000
2	Nr.3	Tavoline MDF me skelet metalik dim.(1600 x 700 x 800 mm)	cope	3	20,000	60,000
4	Nr.5	Raft librash dim.(1300 x 500 x 2800 mm)	cope	6	20,000	120,000
5	Nr.4	Karrige klase druri me skelet metalik	cope	5	3,500	17,500
7	Nr.6	Karrige pritjeje me skelet metalik	cope	27	3,500	94,500
8	Nr.2	Karrige zyre me rrota	cope	2	10,000	20,000
9	Nr.7	Tavoline MDF me skelet metalik dim.(1000 x 500 x 800 mm)	cope	2	15,000	30,000
10		Shtrat Fizioterapie	cope	1	15,000	15,000
11		Shkalle suedeze	cope	1	30,000	30,000
12		Transporti	rruge	2	15,000	30,000
TOTALI			Leke			477,000

Shenim: Cmimet i jane referuar cmimeve te tregut

Konceptori: Ing. Greda Matije

